

Korrupsioni në Arsim – Vëllimi II: Imuniteti i Humbur i Sistemit dhe Mekanizmat e Shërimit Institucional

Kamila Seidolli

Student, Fakulteti i Drejtësisë, Universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës

Tetor 2025

Ky artikull u realizua në kuadër të projektit "Fuqizimi i Studentëve për Integritet: Lufta kundër Korrupsionit në Arsimin e Lartë", i cili zbatohet nga Qendra ALTRI. Projekti është pjesë e Programit të Granteve të Vogla SELDI, në kuadër të projektit “Shoqëria Civile për Qeverisje të Mirë dhe Kundër Korrupsionit në Evropën Juglindore: Ndërtimi i Kapaciteteve për Avokim të Bazuar në Evidencë, Ndikim në Politika dhe Angazhim të Qytetarëve (SELDI.net)”, i financuar nga Bashkimi Evropian. Përmbajtja e këtij materiali është përgjegjësi e vetme e Qendrës ALTRI dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht qëndrimet e Bashkimit Evropian apo të SELDI.net.

Abstrakt

Në vijim të analizës së mëparshme mbi korrupsionin si “sëmundje patogjene” që ka infektuar trupin e sistemit arsimor shqiptar, ky artikull paraqet një qasje të re: shërimin institucional dhe ndërtimin e imunitetit etik të arsimit. Nëse dikur korrupsioni shihej si infeksion aktiv, sot ai është bërë pjesë e ADN-së administrative dhe kulturore. Përmes një qasjeje analitike dhe metaforike, punimi shqyrton “mutacionet” e korrupsionit në arsimin digjital, ndikimin e teknologjisë, rezistencën e institucioneve dhe përpjekjet për të krijuar një sistem me antitropa të qëndrueshëm: transparencën, përgjegjësinë dhe meritokracinë. Artikulli përfundon me një paketë propozimesh konkrete për ndërtimin e “imunitetit institucional”, si parakusht për një arsim të shëndetshëm dhe të drejtë.

Fjalë kyçe: korrupsion, arsim, imunitet institucional, etikë, reforma digjitale, transparencë.

Hyrje – Nga infeksioni te rikuperimi

Në analizën e parë, korrupsioni u përshkrua si një virus që përhapet në trupin e shoqërisë përmes sistemit arsimor, duke dobësuar funksionet jetësore të edukimit. Në vitet e fundit, megjithatë, ky virus nuk është më thjesht një infeksion i dukshëm; ai është bërë i brendësuar në indet e sistemit në vendimmarrje, në kulturën administrative dhe madje në mënyrën se si perceptohet suksesi. Kjo tregon se sfida nuk është më vetëm parandaluese, por kërkon rindërtim të thellë dhe të qëndrueshëm.

Në këtë vëllim të dytë, arsimi shihet si një organizëm që mund të shërohet; një trup që, pavarësisht infektimit të kaluar, ka potencial për të zhvilluar imunitet etik dhe institucional. Lufta kundër korrupsionit nuk mund të reduktohet thjesht në dënimin e individëve, por kërkon ndërtimin e mekanizmave mbrojtës të brendshëm, ku integriteti, transparenca dhe llogaridhënia veprojnë si antitropa që neutralizojnë infeksionin dhe parandalojnë përhapjen e tij. Ky proces nuk është vetëm një reformë administrative, por një ndryshim kulturor dhe moral, që synon të krijojë një arsimin më të fortë, më të drejtë dhe më të besueshëm, i aftë të prodhojë qytetarë të ndërgjegjshëm dhe një shoqëri të qëndrueshme.

Për të kuptuar gjendjen aktuale të arsimit shqiptar, është e nevojshme të shihet se si korrupsioni është përshtatur dhe ka mbijetuar brenda reformave të fundit arsimore. Sipas të dhënave të INSTAT (2024) dhe Transparency International (2024), besimi publik në institucionet arsimore mbetet në nivele të ulëta; rreth 65% e qytetarëve e perceptojnë arsimin e lartë si “të korruptuar” ose “të ndikuar politikisht”. Ky perceptim tregon qartë se, edhe pse mekanizmat formale të kontrollit janë shtuar, ata nuk kanë prodhuar një imunitet të qëndrueshëm, por vetëm antitropa të dobët, të paaftë për të penguar rikthimin e infeksionit. Në këtë kontekst, mund të dallohen tre shenja të dukshme që tregojnë përmbajtjen kronike të problemit. Së pari, normalizimi i korrupsionit të vogël, që shfaqet në pagesa të vogla për nota, favore administrative ose përparësi në konkurse, duke e bërë praktikën të duket e zakonshme dhe të padëmshme. Së dyti, imuniteti selektiv, ku ligjet dhe rregulloret ekzistojnë, por zbatohen vetëm në raste të izoluar, pa prekur strukturat e larta që vazhdojnë të operojnë jashtë përgjegjësisë. Së treti, përhapja digjitale e abuzimeve, ku manipulimi i të dhënave dhe i platformave elektronike ka krijuar një “mutacion” të ri të korrupsionit, duke e bërë më të vështirë identifikimin dhe parandalimin e tij në mjedisin online. Në këtë fazë, arsimi shqiptar ndodhet në një situatë kronike, ku simptomat janë të zbutura, por të qëndrueshme. Kjo e bën edhe më të vështirë shërimin, sepse korrupsioni nuk perceptohet më si një sëmundje që duhet luftuar, por si një element i natyrshëm i sistemit. Për të krijuar një sistem të shëndetshëm dhe të besueshëm, është e nevojshme një qasje integrale që kombinojë

forcimin e mekanizmave institucionale me ndërgjegjësimin shoqëror dhe kultivimin e një lidhshirë morale. **Mutacionet e korrupsionit: format e reja në epokën digjitale**

Në dekadën e fundit, teknologjia është parë si ilaçi që do të shërojë administratën publike nga korrupsioni. Megjithatë, në shumë raste, virusi është përshtatur ndaj ilaçit. Korrupsioni në arsim është “mutuar” në disa forma të reja si:

- a) **Korrupsioni algoritmik** - Në universitetet që përdorin sisteme digjitale për menaxhimin e notave apo regjistrimeve, janë shfaqur manipulime të fshehta të të dhënave. Ndërhijet në sistemet elektronike bëhen nga brenda, duke ndryshuar nota ose rezultate, pa lënë gjurmë fizike. Kjo formë e re e korrupsionit është e padukshme dhe kërkon auditim të specializuar teknik.
- b) **Korrupsioni përmes projekteve dhe fondeve të zhvillimit** - Në emër të modernizimit, shumë universitete kanë marrë fonde për pajisje teknologjike, të cilat nuk janë përdorur kurrë. Në këtë rast, korrupsioni shfaqet si parazit institucional, që ushqehet nga projektet ndërkombëtare dhe e paraqet veten si “reformë”.
- c) **Favorizimi akademik digjital** – Në mjediset virtuale, ku komunikimi me pedagogët ndodh online, është krijuar një zonë gri ku përfitimet informale vazhdojnë në forma të reja si ftesa për bashkëpunime të paguara, influencim në publikime shkencore, ose mbështetje për gradime në këmbim të favoreve. Në të gjitha këto raste, teknologjia nuk ka eliminuar korrupsionin, thjesht e ka bërë atë më inteligjent.
- d) **Imuniteti institucional dhe shoqëror: një strategji për reformë arsimore**
Në çdo trup të sëmurë, mbijetesa varet nga fuqia e sistemit imunitar, një logjikë e ngjashme vlen edhe për arsimin. Një sistem arsimor i fortë nuk është ai që nuk përballet kurrë me sfida, por ai që ka mekanizma të brendshëm kontrolli, etikë të palëkundur dhe transparencë të plotë, duke neutralizuar korrupsionin para se ai të bëhet problem sistematik. Imuniteti institucional ndërtohet përmes rregullave të qarta dhe të zbatueshme njësoj për të gjithë, ndarjes së pushtetit brenda universiteteve përmes rektorateve, senatit dhe bordeve të pavarura, si dhe auditimeve periodike nga njësi të jashtme që garantojnë kontroll objektiv dhe profesional. Ky imunitet nuk është thjesht mekanik, ai kultivohet përmes një kulture të fortë llogaridhënieje, ku çdo vendim, çdo veprim dhe çdo proces vlerësohet sipas standardeve më të larta etike. Megjithatë, fuqia e një sistemi nuk mjafton vetëm me institucione të forta, imuniteti i vërtetë është edhe shoqëror. Kur prindërit refuzojnë të “blejnë notën”, kur studentët nuk pranojnë rrugë të shkurtër dhe kur media ekspozon abuzimet pa frikë, sistemi fillon të prodhojë antitropa etike që forcojnë gjithë komunitetin arsimor. Në këtë mënyrë, lufta kundër korrupsionit transformohet nga ndëshkimi i individëve në një proces arsimimi kombëtar, që krijon një kulturë përgjegjësie, integriteti dhe besimi.

Reforma e vërtetë arsimore nis këtu: duke ndërtuar institucione të forta dhe shoqëri aktive, duke kultivuar lidhshirë morale dhe duke krijuar një sistem ku transparenca dhe llogaridhënia janë parime të pakushtëzuara. Ky është udhërrëfyesi për një arsimin shqiptar të qëndrueshëm, që jo vetëm edukon studentët, por formon qytetarë të ndërgjegjshëm dhe një shoqëri më të drejtë dhe të besueshme

Mekanizmat e shërimit institucional

Për të kaluar nga diagnoza në trajtim, kërkohet një terapi e kombinuar: ligjore, teknologjike dhe kulturore.

- a) **Transparenca si vaksinë** - Të gjitha procedurat akademike nga pranimet deri te shpërndarja e fondeve duhet të jenë publike dhe të aksesueshme online. Çdo student duhet të ketë mundësi të shohë arsyetimin e notës së tij, çdo konkurs të ketë raport publik, çdo fond të ketë gjurmë shpenzimi. Transparenca, si vaksinë, nuk e shëron menjëherë sëmundjen, por e pengon përhapjen e saj.
- b) **Reforma meritokratike e stafit** - Emërimet akademike janë një nga burimet kryesore të “infeksionit”. Nevojitet krijimi i një mekanizmi kombëtar vlerësimi për pedagogët dhe drejtuesit, me kritere të matshme, vlerësim ndër-institucional dhe përfshirje të organizatave të pavarura.
- c) **Edukimi për etikën dhe imunitetin moral** - Korrupsioni nuk fillon në universitet ai fillon në kulturën e përditshme të të mësuarit. Prandaj, edukimi mbi etiken e ndershmërisë duhet të nisë që në arsimin e mesëm. Kjo krijon një brez që e kupton korrupsionin jo si shkelje ligjore, por si cenim moral të vlerave të përbashkëta.
- d) **Përdorimi i inteligjencës artificiale për auditim etik** - Paradoksalisht, teknologjia që ka krijuar korrupsionin digjital mund të bëhet edhe mjeti i shërimit. Sistemet e inteligjencës artificiale mund të përdoren për të analizuar sjelljet anormale në notim, shpërndarje burimesh dhe rekrutime, duke krijuar alarm etik automatik.
- e) **Ndërtimi i “imunitetit të qëndrueshëm”** - Një sistem arsimor i shëndetshëm nuk është ai që nuk përballlet kurrë me sfida apo dobësi morale, por ai që reagon shpejt, riparon dobësitë dhe forcohet përmes çdo testi. Ndërtimi i këtij imuniteti kërkon një qasje të integruar dhe të qëndrueshme, ku universitetet mbështeten nga institucione të pavarura dhe etike, me autoritet real për të udhëhequr dhe mbikëqyrur proceset akademike dhe administrative, duke siguruar që vendimet të jenë gjithmonë të drejta dhe të paanshme.

Mbikëqyrja aktive dhe e vazhdueshme nga shoqëria civile është thelbësore për të garantuar transparencë, llogaridhënie dhe besueshmëri. Një kulturë e re raportimi, ku korrupsioni dhe abuzimet perceptohen si problem kolektiv dhe trajtohen me seriozitet, krijon një ambient ku përgjegjësia është e përbashkët dhe çdo problem adresohet me profesionalizëm dhe qartësi. Më e rëndësishmja, lidhshipi moral është shtylla mbi të cilën ndërtohet ky sistem. Udhëheqësit që e shohin arsimin jo thjesht si një karrierë personale, por si një shërbim publik, vendosin standarde të larta etike, kultivojnë integritet dhe nxisin besim të qëndrueshëm në institucionet arsimore.

Kur këta mekanizma funksionojnë në harmoni, sistemi arsimor transformohet nga një “pacient i dobët” në një organizatë të fuqishme dhe të imunizuar, që jo vetëm përballon sfidat, por edhe prodhon ndershmëri, integritet dhe besim. Ky është imazhi i një arsimi të qëndrueshëm, i cili jo vetëm edukon studentët, por formon qytetarë të përgjegjshëm dhe një shoqëri më të drejtë dhe të besueshme.

Konkluzion

Një sistem arsimor i shëndetshëm nuk është ai që nuk përballlet kurrë me sfida apo dobësi morale, por ai që reagon shpejt, identifikon dobësitë dhe ka aftësinë të riparohet. Institucionet që ndërtojnë mekanizma të fortë kontrolli, etikë të palëkundur dhe transparencë të plotë janë në gjendje të neutralizojnë korrupsionin para se ai të bëhet problem sistematik. Ky imunitet institucional shprehet

përmes rregullave të qarta dhe të zbatueshme për të gjithë, ndarjes së pushtetit brenda universiteteve përmes rektorateve, senatit dhe bordeve të pavarura, si dhe auditimeve periodike nga njësi të jashtme, të cilat garantojnë kontroll objektiv dhe profesional. Më e rëndësishmja, ai kultivohet përmes një kulture të fortë llogaridhënieje, ku çdo vendim dhe çdo proces vlerësohet sipas standardeve më të larta etike.

Por fuqia e sistemit nuk mjafton vetëm me institucione të forta; imuniteti i vërtetë është edhe shoqëror. Kur prindërit refuzojnë të “blejnë notën”, kur studentët nuk pranojnë rrugë të shkurtëra dhe kur media ekspozon abuzimet pa frikë, sistemi fillon të prodhojë “antitrupa etikë” që forcojnë gjithë komunitetin arsimor. Në këtë mënyrë, lufta kundër korrupsionit nuk është më thjesht ndëshkimi i individëve, por bëhet një proces arsimimi kombëtar, që kultivon përgjegjësi, integritet dhe besim.

Në këtë kontekst, korrupsioni nuk shihet më si një infeksion i papritur, por si një sëmundje kronike e trashëguar, që mund të menaxhohet vetëm përmes kujdesit të vazhdueshëm dhe mekanizmave të qëndrueshëm. Arsimi shqiptar është ende në proces rikuperimi: shenjat e sëmundjes janë të dukshme, por ekzistojnë edhe simptomat e shërimit, vetëdijesimi publik, përfshirja e teknologjisë, presioni qytetar dhe rritja e ndëshkueshmërisë tregojnë se ndryshimi është i mundur.

Referenca

- **INSTAT. (2024). *Education in Albania: Data for the Academic Year 2023–2024*.**
- **Transparency International. (2024). *Corruption Perceptions Index and Albania Country Profile*.**
- **Shahini, A., Zhllima, E., & Imami, D. (2024). *Politics of Corruption in Albanian Higher Education*. Studies of Transition States and Societies.**
- **Friedrich Ebert Stiftung. (2024). *Integrity and Accountability in Higher Education*.**
- **Institute for Strategic Research and Education (ISIE). (2023). *Study on Corruption Perceptions in Higher Education in Albania, North Macedonia and Serbia*.**
- **European Commission. (2025). *Rule of Law Report – Albania Chapter*.**